



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_270_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_426_06_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_426_06_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 26.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Hilmi Alushaj (shifra e konsumatorit DPZ – 43035) nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 28.02.2008 ka apeluar përgjigjen e Departamenti për Konsumatorë në KEK të datës 26.02.2008, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 14.09.2007 konsumatori ka parashtruar kërkesë në KEK për ndërrimin e njehsorit elektrik.
- Me datë 14.09.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorin ku ka hequr nga matje njehsorin elektrik nr. 17702792 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 44192980.
Provë: Procesverbali i KEK-ut për ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0360 të datës 14.09.2007
- Me datë 28.09.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit në KEK kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17702792 në të cilin është konstatuar se bllobat shtetërore dhe numëruesi i manipuluar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 1/28 të datës 28.09.2007

- Me datë 01.02.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe ka bërë regjistrimin e pikës matëse ku është profili i kabllit furnizues, 4 x 4 mm².
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 038209 të datës 01.02.2008
- Me datë 15.02.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04096 në vlerë prej 1,687.33 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 26.02.2008 konsumatori iu është drejtuar Departamentit për Konsumator në KEK duke kundërshtuar dënimin e ngarkuar nga ana e KEK-ut.
- Me datë 26.02.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin n e kontrollës nr. 038209 dhe procesverbalin e kalibrimin.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 26.02.2008
- Me datë 28.02.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-u në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 426_06_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar